



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Nr. Prot. 4199

Tiranë, më 5.10.2023

Shpallje e kërkesës për aplikime për hartues të fondit të pyetjeve të MSH 2024

Qendra e Shërbimeve Arsimore shpall thirrjen për shprehje interesi për hartues të fondit të pyetjeve për MSH 2024.

Kriteret:

- Ushtron profesionin e mësuesit sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi;
- Ka të paktën 10 (dhjetë) vjet përvojë pune si mësues;
- Ka dhënë lëndën të paktën 1 (një) herë në të gjitha klasat e gjimnazit;
- Ka të paktën kategorinë e kualifikimit mësues i kualifikuar dhe është vlerësuar në kualifikimin e mësuesve me “Shumë mirë”;
- Preferohet të ketë eksperiencë në hartimin e pyetjeve për provimet kombëtare.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Curriculum Vitae;
- Kopje të diplomës së arsimit të lartë.
- Vërtetim nga ZVAP/shkolla që jep mësim prej të paktën 10 viteve në gjimnaz;
- Vërtetim nga shkolla që e ka dhënë lëndën në të tri vitet e gjimnazit;
- Kopje e certifikatës së kualifikimit të mësuesve.

Procedura e aplikimit:

Qendra e Shërbimeve Arsimore do të pranojë vetëm aplikime që janë përcjellë me rrugë postare në adresën e mëposhtme:

*Qendra e Shërbimeve Arsimore
Blv. Zhan D'Ark, Nr. 23, Tiranë*

Afati i dorëzimit të aplikimeve:

Aplikimet mund të dërgohen në rrugë postare nga data 05.10.2023-11.10.2023.

Aurora BALLIU

DREJTOR I PËRCJUTSHËM

